



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Legjislatura e III-të

Nr. 25/09

Prishtinë, më 15.10.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Bojan Stojanović, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Enis Kervan, Hetem Arifi, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha dhe Xhevdet Neziraj.**

Anëtarët e jo të pranishëm të Komisionit: **Sanije Aliaj, Müfera Şinik dhe Zafir Berisha.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitruer nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.**

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendite te ditës;**
2. **Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 22.07.2009;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar nr. 03/L-146 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente;**

6. **Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente;**
7. **Debat për dokumentacionin (kushtet) e kërkuar për marrjen e shtetësisë së Kosovës**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Numan Balić, propozoi që në kuadër të rendit të ditës të shqyrtohen edhe dy çështje. E para ka të bëjë miratimin e raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve i cili do të procedohet në Kuvend, dhe çështja e dytë ka të bëjë me dokumentacionet apo kushtet që kërkohen për marrjen e shtetësisë.

Kryesuesi, për propozimin e parë të z. Balic, theksoi se do të shqyrtohet në një mbledhje të veçantë të komisionit. Ndërsa për propozimin e dytë, kërkoi që të jetë objekt diskutimi i kësaj mbledhje, dhe të jetë pika e shtatë e rendit të ditës.

Propozimi u përkrah njëzëri. Rendi ditës plotësohet me pikën e re: Debat për dokumentacionin (kushtet) e kërkuara për marrjen e shtetësisë. Pika e shtatë e rendit të ditës bëhet pika e tetë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 22 korrik 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 22 korrik 2009, u miratua pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente**

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente**

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për masat antidamping, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar nr. 03/L-146 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente

Kosara Nikolić, theksoi se në klauzolën e raporti është bërë një gabim teknik, është përmendur Ligji për Auditimin e Brendshëm. Po ashtu te amendamenti 7, definicioni “të drejtat in rem”, nuk e kanë kuptimin e mirë në gjuhën serbe. Pastaj në Amendamentin 25, neni 2.2.1 duhet të jetë vitit të tatimit, e jo periudhës tatimore. Po ashtu termi i përmendur “rimbursimet” nuk ekziston në gjuhën serbe. Prandaj duhet bërë këto korrigjime.

Kryesuesi, kërkoi që këto vërejtje të përgatiten me shkrim, dhe si rezultat miratimi i këtij projektligji me amendamente e propozuara të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I.** Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar nr. 03/L-146 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente e propozuara, shtyhet për në mbledhjen e radhës së komisionit.
- II.** Vërejtjet e anëtarëve për projektligjin dhe amendamentet, të bëhen me shkrim në formë të propozim-amendamenteve, që do të jenë objekt diskutimi dhe votimi në komision.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Numan Balić, theksoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk parashohin edhe ndarjen e dekoratave për njerëzit nga komunitetet tjera joshumicë. Kërkojë që Komisioni të dal me një kërkesë që Ligji të plotësohet, në të cilën do të thuhet se ndarje e medaljeve apo dekoratave bëhet edhe për komunitetet joshumicë apo ngjarjet kulturore të këtyre komuniteteve.

Zylfi Merxha, në diskutimin e parafolësit, theksoi se është e drejtë e kryetarit të vendos për ndarjen e dekoratave, dhe ne nuk duhet të përzihemi në të drejta të tij.

Kryesuesi, theksoi se nuk po kontestohet e drejta e kryetarit për ndarjen e dekoratave, por është e nevojshme të rregullohet me ligj ndarja e dekoratave edhe për komunitetet tjera.

Sadik Idriz, theksoi se është dashur që këto çështje të ngriten në leximin e parë bërë këtij projektligji. Megjithatë propozoj që të shtyhet deri në mbledhjen e radhës, dhe të mendojmë deri atëherë se si mund të plotësohet ky projektligj në ndarjen e medaljeve për komunitetet joshumicë.

Xhevdet Neziraj, u pajtuar që ky projektligj të shtyhet për në mbledhjen e radhës. Komisioni mund të dal me propozime konkrete që do mund t'iu dërgoheshin edhe Këshillit Konsultativ për Komunitete, të cilin e kryeson Presidentit, dhe të rregullohet çështje e ndarjes së dekoratave edhe për komunitetet tjera joshumicë.

Kryesuesi, u pajtua me propozimet që kjo pikë, të shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit. Në konsultim edhe me institucionet ndërkombëtare, të analizohet kjo çështje, dhe me ligj të rregullohet çështja e ndarjes së dekoratave për komunitetet tjera.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Shqyrtimi i Projektligjit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente, shtyhet për në mbledhjen e radhës së komisionit.
- II. Komisionit do të dal me propozim-amendamentet konkrete, për plotësimin e këtij projektligji, në ndarjen e dekoratave nga Presidenti për komunitetet tjera joshumicë në Kosovë.

8. Debat për dokumentacionin (kushtet) e kërkuar për marrjen e shtetësisë së Kosovës

Numan Balić, njoftoi se nga takimet që ka pasur me qytetarë, është njoftuar se për të marrë shtetësinë iu kërkohej një numër i madh i dokumentacioneve. Dhe si rezultat ata trajtohen si banorë të huaj, edhe janë banorë të Kosovës, (kanë pronën dhe shtëpi këtu). Më pas lexoj shkresën e cila mban vulën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për kushtet që duhet plotësuar për marrjen e shtetësisë me natyralizim. Shumicën e këtyre kushteve i konsideroi të pakuptueshme dhe të papranueshme, si antikushtetuese dhe në kundërshtim me normat ndërkombëtare. E njëjta situatë është edhe për shtetësinë për të miturit. Prandaj kërkoi që Komisioni të kërkojë nga institucionet përgjegjëse, të tërheqin këto kërkesat joligjore për marrjen e shtetësisë.

Kryesuesi, u pajtua se duhet të reagohej për tu ndryshuar këto kushte për marrjen e shtetësisë. Të njëjtat problem po shfaqen edhe për komunitetin serb, dhe kjo çështje ndërlidhet me gjithë qytetarët e që kanë nevoja të këtilla.

Xhevdet Neziraj, theksoi se mund të ketë ndodhur që edhe referentët të kenë gabuar në dhënien e informacioneve. Por pasi që shkresa mban vulën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, propozoi të ftohet personat përgjegjës nga kjo Ministri për të dhënë sqarime lidhur me këtë çështje.

Hetem Arifi, nga përvoja që punon Qendrën e Regjistrimit Civil, theksoi se ka raste kur mjetet e identifikimit të UNIMK-ut i kanë marrë qytetarët edhe nga shtetet tjera (Maqedonia, Shqipëria). Por megjithatë disa nga kërkesat e paraqitura duken të pakuptueshme. Prandaj propozoi që në fillim të shikohet Ligji për Shtetësinë, për të parë se a po përpunohen kushte me ligjin.

Kosara Nikolić, gjithashtu theksoi se ka dëgjuar nga qytetarët se për të marrë shtetësinë kërkohen shumë dokumentacione, gjë që po shifet edhe nga kjo shkresë, e që shumica prej këtyre dokumenteve janë të pakuptueshme. U pajtua me propozimin që Komision të kërkojë sqarim nga institucionet relevante për këtë çështje.

Sadik Idriz, theksoi se Ligji për Shtetësinë është pjesë e ligjeve të Pakos së Ahtisarit, të miratuar në Kuvend. Aty janë të sqaruar kushtet për fitimin e shtetësisë me natyralizim. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shtetësinë e lindjes. Prandaj që Komisioni të mos del qesharak në reagimet e tija, paraprakisht propozoi të shikohet ligji, e më pas të reagohej me shkresë ndaj institucioneve përgjegjëse.

Numan Balić, në reagimin diskutuesve, theksoi se kemi të bëjmë me shtetas të Kosovës, që kanë dëshmitë se janë vendas dhe nuk iu lëshohet shtetësia. Trajtohen si të huaj dhe shkelet ligji.

Kryesuesi, meqë ka disa paqartësi për këtë çështje, pasi që dokumenti përmban vulën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, propozoi që kjo çështje të diskutohen në mbledhjen e ardhshëm të Komisionit, në të cilën do të ftohet Ministri për të dhënë sqarime për kushtet për marrje shtetësisë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Debati për dokumentacionin (kushtet) e kërkuar për marrjen e shtetësisë në Kosovë shtyhet në një mbledhje tjetër të Komisioni, në të cilën do të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme për të dhënë sqarime për këtë çështje.

9. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi se lidhur me projektligjin për shitjen e banesave kemi disa propozime konkrete nga OSCE, të cilat do të duhej diskutoheshin në nëngrupin punues të Komisionit për të harmonizuar qëndrimet. Në këto takime mund të marrin pjesë edhe përfaqësuesit nga ICO dhe Ambasada Amerikane. Më pas propozimet do të kalojnë për aprovim në Komision.

Xhevdet Neziraj, ngriti dy çështje, e para që për monitorimin e ligjeve nga grupi punues, të hartohet raporti i cili duhet dorëzohet Kuvendit (me të cilën do të tregohet rrjedha e procedurës së monitorimit të ligjeve dhe gjendja në institucionet e monitoruara). Ndërsa për çështjen e dytë u interesua të dinte për realizimi e vizitës së premtuar në Zvicër.

Jenny Fillkins, theksoi se në bashkëpunim me stafin e OSCE janë angazhuar që të analizojnë këtë ligj dhe të japin propozimet për nevojën e ndryshimit të tij. Janë disa çështje që kërkojnë sqarim për këtë ligj, të cilat në detale do të diskutohen në takimin me grupin punues. Në pika të përgjithshme janë disa çështje që duhet ngritur. Së pari banesat janë pronë shoqërore dhe duhet të jenë nën administrimin e AKP-së, ndërsa në ligj nuk përmendet AKP-ja, gjithashtu nuk përmendet as Agjencioni i Pronë, edhe pse kemi të bëjmë me pronësinë e banesave.

Xhevdet Neziraj, theksoi se mund të propozojmë amendamentet komisionit funksional apo edhe të mbajmë një takim të përbashkët.

Kryesuesi, falënderoi OSCE për ndihmën e ofruar. Theksoi se në momentin që rregullohet çështjet diskutabile, ky komision nuk do të paraqet pengesa.

Numan Balić, vlerësoi vërejtët e propozuara nga OSCE si shumë të rëndësishme. Të realizojmë takimin e përbashkët me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të ICO dhe të zgjidhet kjo çështje.

Kosara Nikolic, theksoi se edhe për Ligjin për të drejtat sendore ka pasur vërejtje për çka nuk iu është dhënë fjala në seancë. Prandaj të mos ndodh që edhe ky ligj të kalojë sikurse ai, kur dihet se ka shumë çështje që duhet plotësuar atë.

Elita Vokshi (OSCE), për udhëtimin në Zvicër, njoftoi se nga takimi që ka pasur me personat e këtij programi ka mësuar, për shkak të zgjedhjeve lokale, janë të interesuar që kjo vizitë të realizohet në fund të nëntorit apo fillim të dhjetorit. Mirëpo kjo nuk është zyrtare. OSCE është e gatshme të mbështet financiarisht këtë vizitë dhe ka ndarë mjetet për këtë qëllim.

Mbledhja përfundoi në ora 12:35

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Bojan STOJANOVIĆ